REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.8677/10 Prot. Sarandë, më 03.12.2025

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00
Data e mbajtjes së mbledhjes :27.11.2025
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: Kryetar i Bashkisë Z.Oltion Çaçi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Gjergji Imeraj
3. Festim Mina
4. Zana Piro
5. Laureta Çeçi
6. Vesel Koçiu
7. Dritan Peçi
8. Enea Vasili
9. Denisa Islamaj
10. Përparim Ahmeti
11. Thanas Gurma
12. Lindita Kondi
13. Ilirjan Gërdhuqi
14. Xhino Jaçaj
15. Bejdo Çela
16. Anjeza Dike
17. Dafina Allkushi
18. Eugen Qëndro
19. Elona Mano

20. Ermir Hoxha

Mungojnë :

21. Ilva Qëndro
22. Klejdjan Murtaj
23. Kevin Alikaj
24. Ibrahim Bajrami
25. Angjele Lapa
26. Indi Rrapaj
27. Farie Hyska
28. Katerina Beqo
29. Pranvera Osmani
30. Shpëtim Ahmeti

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 27.11.2025, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Tetor 2025".
2. **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Tetor 2025".
3. **P/vendim** "Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Sarandë për vitin 2026".
4. **P/vendim "** Për miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Sarandë për periudhën janar - dhjetor 2026".
5. **P/vendim** "Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Sarandë për vitin 2025".
6. **P/vendim "** Për korrigjimin e gabimeve materiale".
7. Raport mbi shërbimin veterinare dhe tregjet publike të Bashkisë.
8. Raport mbi performancën e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës .

Miratohet me 20 vota pro rendi i ditës .
Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin tetor 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 20 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin tetor 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 20 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës**: P/vendim** "Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Sarandë për vitin 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Ilir Gwrdhuqi : Pati një diskutim, dhe një propozim, domethënë duke marrë parasysh kërkesat e grupeve të interesit në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, po duke qenë dhe propozimi ishte konkret që taksa e ndikimit në infrastrukturë për volumet ndërtimore që ndodhen nga kati zero, dhe poshtë, domethënë pjesa e garazheve e kështu të përgjysmohet. Por duke qenë se jemi pranë vendosjes së referencave, nivelit të referencave sipas zonave nga qeveria, menduam që ky propozim të shtyhet dhe të caktohe në një mbledhje tani afër në janar, duke qenë se presim tani në janar të dalin nivelet e referencave të reja. Se Saranda është në tërësi, domethënë është e kanë caktuar si zone nw tërësi, por do ketë specifika me me zona të caktuara, do ketë nivele të ndryshme referencash. Kështu që na, kur të vijë momenti që të caktojmë ato nivele, të bëjmë dhe ne ndërhyrjen e duhur, të caktojmë, për garazhet të taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Një pikë tjetër që u diskutua, Sipas raportimeve të marra, një numër i konsiderueshëm parkimesh në zona të ndryshme urbane janë të zëna në mënyrë të vazhdueshme nga mjete të ndryshme, pa pagesë dhe pa regjistrim në sistemin e parkimeve të bashkisë. Kjo situatë po krijon shqetësime të vazhdueshme për përdoruesit e shërbimit, duke cenuar rregullin, transparencën dhe të ardhurat e bashkisë.

Në këtë kuadër, Komisioni i Ekonomisë kërkon:

1. Identifikimin e plotë të të gjitha hapësirave të parkimit që rezultojnë të zëna pa pagesë, duke përfshirë lokacionin, numrin e mjeteve.
2. Verifikimin nëse këto hapësira janë të miratuara si përjashtime, apo po përdoren në mënyrë të paligjshme nga individë apo subjekte të caktuara.
3. Paraqitjen e një raporti zyrtar pranë Komisionit, brenda një afati të arsyeshëm, me gjetjet dhe masat e propozuara për normalizimin e situatës.
4. Nëse vërtetohet keqpërdorim, ndërmarrjen e menjëhershme të masave administrative për rikthimin e funksionimit të rregullt të parkimeve publike.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 20 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: **P/vendim "** Për miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Sarandë për periudhën janar - dhjetor 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 20 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Sarandë për vitin 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 20 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: **P/vendim** " Miratim i korrigjimit të gabimeve materiale".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimet një nga një

Miratohen me 20 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës

Raport mbi shërbimin veterinare dhe tregjet publike të Bashkisë.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 7 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tetë të rendit të ditës

Raport mbi performancën e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka : Duke ju falenderuar , e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky proçesverbal mbyllet me nr.rendor 5 (pesë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Valbona Vasili

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

1.	Kryetar i Këshillit Bashkiak :	Asaf Stroka
2.	Partia Socialiste e Shqipërisë:	Lindita Kondi
3.	Partia,Drejtësi,Integrim dhe Unitet:	Klejdjan Murtaj
4.	Partia Balli Kombëtar:	Bejdo Çela
5.	Partia Republikane Shqiptare :	Përparim Ahmeti
6.	Fryma e Re Demokratike:	Ilir Gërdhuqi
7.	Kryetar i Grupit Bashkë Fitojmë:	Shpëtim Ahmeti
8.	Kryetar i Grupit Partia Demokratike:	Vesel Koçiu
9.	Aleanca Arbnore Kombëtare:	Xhino Jaçaj
10.	I pavarur	Kevin Alikaj